



Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës,

Në mbështetje të nenit 3.5 pika (ii), 15.1 pika (a), (c), (e), (f), 21.2, 78, 79 dhe 80 pika (a) dhe (b) të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Viti III, Nr. 28, dt. 4 qershor 2008),

Duke marrë parasysh,

Obligimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës në lidhje me Marrëveshjen Shumëpalëshe për Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (më tej referuar si "Marrëveshja për HPEA") që nga hyrja saj e përkohshme në fuqi për Kosovën, më 10 tetor 2006,

Me qëllim të zbatimit të Rregullores së Komisionit Evropian nr. (EU) 70/2010 për vendosjen e kërkesave mbi cilësinë e të dhënave dhe informatave aeronautike për Qiellin e Vetëm Evropian, në kuadër të rendit të brendshëm juridik të Republikës së Kosovës,

Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik me të gjitha palët e interesuara në pajtim me Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2012 për konsultimin publik të palëve të interesuara,

Nxjerr këtë:

**RREGULLORE Nr. 8/2015 PËR
kërkesat e cilësisë së të dhënave dhe informatave aeronautike për qiellin e vetëm evropian**

Neni 1

Rregullorja e Komisionit Evropian (EU) Nr. 73/2010, dt. 26 janar 2010 për vendosjen e kërkesave mbi cilësinë e të dhënave dhe informatave aeronautike për Qiellin e Vetëm Evropian shpallet e zbatueshme në Republikën e Kosovës. Rregullorja e Komisionit Nr. 73/2010 i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje si shtojcë dhe formon pjesën e saj përbërëse.

Neni 2

2.1 Dispozitat e neneve 1 deri 13 dhe Shtojcat I deri X të Rregullores së Komisionit Nr. 73/2010 janë të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

2.2 Çdo dispozitë e amendamenteve të ardhshme të Rregullores së Komisionit Nr. 73/2010, siç paraqitet në Shtojcën I të Marrëveshjes për HPEA, do të jetë e zbatueshme drejtpërsëdrejti në Republikën e Kosovës.

Neni 3

3.1 Përkufizimet e shprehjeve dhe termave të përdorura në këtë Rregullore janë të përfshira në nenin 3 të Rregullores së Komisionit.

3.2 Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, shprehjet "Komuniteti", "Ligji i Komunitetit", "Legjislacioni i Komunitetit", "Instrumentet e Komunitetit", "Traktati i KE", "Aeroport i Komunitetit", "Gazeta Zyrtare e Komuniteteve Evropiane", "Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian", "Transportues Ajror i Komunitetit" dhe "Shtet(e) Anëtar(e)", të cilat mund të referohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthorazi në Rregulloren e Komisionit, duhet të lexohen në përputhje me Pikat 2 dhe 3 të Shtojcës II të Marrëveshjes për HPEA.

3.3. Për nevoja të kësaj Rregulloreje, "Autoriteti Mbikëqyrës Kombëtar", siç referohet në Rregulloren e Komisionit Nr. 73/2010, në kontekstin e Republikës së Kosovës do të nënkupton Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës.

Neni 4

Në rast të interpretimit të Rregullores së Komisionit do të përdoret versioni origjinal në gjuhën angleze, siç është publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Neni 5

Kjo Rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas nënshkrimit.

Prishtinë, 9 korrik 2015.

Dritan Gjonbalaj
Drejtor i Përgjithshëm